



SHOQATA E SIGURIMEVE TË KOSOVËS
INSURANCE ASSOCIATION OF KOSOVA

KODI ETIK I INDUSTRISË SË SIGURIMEVE

PËRMBAJTJA

KODI ETIK I INDUSTRISË SË SIGURIMEVE

| | |
|---|-----------|
| HYRJE | 3 |
| I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME | 4 |
| 1.1. Informimi dhe respektimi i Kodit Etik të industrisë së sigurimeve | 4 |
| 1.2. Përgjegjësia e personave juridik të perfshirë në industrinë e sigurimeve | 4 |
| 1.3. Mbrojtja e autoritetit të siguruesve | 4 |
| 1.4. Parimi i besimit reciprok dhe e drejta për mbrojtjen e palës | 5 |
| 1.5. Marrëdhëniet e siguruesve dhe personave tjerë | 5 |
| 1.6. Angazhimi mbi zhvillimin mëtejm të veprimtarisë së sigurimeve | 5 |
| II. MARRËDHËNIET NDAJ PALËVE | 6 |
| 2.1. Informimi i drejt i palëve para lidhjes së kontratës të sigurimit | 6 |
| 2.2 Trajtimi i pa anshëm i palëve dhe trajtimi i kompenzimit të dëmit sipas kushteve te kontratës së sigurimit | 6 |
| 2.3. Zgjidhja e ankesave të palëve | 7 |
| 2.4. Aplikimi i dispozitave juridike dhe rregullave të sigurimeve..... | 7 |
| III. MARRËDHËNIET NË MES TË OPERUESVE TË SIGURIMEVE | 8 |
| 3.1. Parimet kryesore | 8 |
| 3.2. Solidariteti reciprok..... | 9 |
| IV. MBLEDHJA, TRAJTIMI, SHFRYTËZIMI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE | 9 |
| 4.1. Mbledhja, trajtimi, shfrytëzimi dhe mbajtja në diskrecion i të dhenave dhe mbrojtja e të dhënave personale..... | 9 |
| 4.2. Mbedhja, trajtimi dhe publikimi i të dhënave që kanë te bëjnë me afarizmin e kompanisë..... | 9 |
| 4.3. Shkëmbimi i të dhënave në mes të Siguruesve..... | 9 |
| 4.3. Shkëmbimi i të dhënave në mes të Siguruesve..... | 9 |
| V. PREZENTIMI I SIGURUESVE NË TREG | 10 |
| 5.1. Respektimi i konkurrencës së tregut të lirë | 10 |
| 5.2. Promocioni Ekonomik..... | 10 |
| 5.3. Sjellje e pa tolerueshme | 10 |
| VI. KONKURENCJA JO LOJALE NË VEPRIMTARINË E SIGURIMEVE | 13 |
| VII. SPEKULIMI NË PUNËT E SIGURIMEVE | 13 |
| VIII. PARANDALIMI DHE SANKSIONET PËR SHKELJE TË KODIT | 14 |
| 8.1 Masat për shkelje të Kodit janë:..... | 14 |
| IX. KOMISIONI PËR SHKELJEN E KODIT ETIK | 15 |
| X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE | 16 |
| 10.1. Informimi me Kodin | 16 |
| 10.2. Hyrja e Kodit ne fuqi..... | 16 |

Konform me dispozitat e Statutit të Shoqatës të Sigurimeve të Kosovës neni 4.1 al a dhe d, si dhe neni 4.2 al b, me qëllim të ngritjes së biznesit të sigurimeve, bazuar në praktikat e ndershme dhe të sinqerta, ngritjen e marrëdhënieve profesionale ndaj palëve, ngritjen e mirëbesimit të ndërsjellë dhe ngritjen e marrëdhënieve kolegiale, duke i respektuar dispozitat juridike, që kanë të bëjnë me sigurimet, Bordi i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 11.03.2014 e aprovoi:

KODI ETIK I INDUSTRISË SË SIGURIMEVE

HYRJE

NE anëtarët e Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës nëpërmjet zotimit tonë, përpilojmë dhe formulojmë Kodin Etik i industrisë së sigurimeve "Kodi", në të cilin përfshihen praktikat e drejta, dhe etike të afarizmit të sigurimeve, si dhe sjelljet në mes nesh dhe në lidhje me organizatat, institucionet dhe personat e tjerë, e në veçanti përballë klientëve, dhe mes Kompanive të Sigurimit, e të cilat do të aplikohen sipas principeve të shëndosha etike.

Përkufizimet/Shprehjet dhe fjalët e përdorura në këtë Kod i kanë këto kuptime:

1. „punët e sigurimeve“ do të thonë lidhja dhe ekzekutimi i kontratave të sigurimit dhe ndërmarrja e masave për pengimin dhe parandalimin e rreziqeve që u kanosen personave dhe sendeve, përkatesisht pasurisë;
2. „punët e bashkësigurimeve“ do të thonë lidhja dhe ekzekutimi i kontratave të sigurimit me më shumë se një sigurues, të cilët janë marrë vesh për mbulesën e përbashkët dhe për ndarjen e rrezikut, në mënyrë që çdo sigurues i shënuar në policë të sigurimit t'i përgjigjet të siguruarit për kompenzimin e plotë të dëmit;
3. „punët e risigurimeve“ do të thonë lidhja dhe ekzekutimi i kontratës së risigurimeve mbi limitin e vetëmbajtur të rrezikut të kompanive tek kompanitë e risigurimeve;
4. „punët e ofrimit të shërbimeve të tjera në sigurime“ do të thonë ndërmjetësimi dhe përfaqësimi në sigurime dhe risigurime, incizime/regjistrime të rrezikut, incizime/regjistrime të vlerësimeve të dëmeve dhe ofrim i shërbimeve intelektuale dhe teknike lidhur me punët e sigurimeve, si edhe ofrim i atyre shërbimeve një kompanie tjetër të sigurimeve;
5. „sigurues“ nënkupton kompanitë dhe degët e kompanive të sigurimit, që operojnë në Kosovë.
6. „risigurues“ do të thotë kompani e regjistruar për kryerje të punëve të risigurimeve;
7. „ndërmjetësues i sigurimeve“ do të thotë person i autorizuar/licencuar për ofrimin e ndermjetesimit në sigurime;
8. „klient“ do të thotë i siguruar, kontraktues i sigurimit, person i dëmtuar ose shfrytëzues i sigurimit, palë në punën e sigurimeve;
9. „promociion ekonomik“, „reklama të gazetave“, „shpallje“, „propagandim“ dhe „reklamim“ do të thotë reklamim, ofertë e kushteve dhe të metodave të tjera, me të cilat reklamohet puna/afarizmi i sigurimeve nga ana e siguruesve, risiguruesve ose e ndërmjetësuesve të sigurimeve.
10. Shprehjet dhe fjalët e tjera kanë kuptimin, i cili i përgjigjet përbajtjes së atyre shprehjeve dhe fjalëve, që rezultojnë nga Ligji për marrëdhëniet e detyriimeve si dhe ligjet e tjera të cilat e rregullojnë fushën e sigurimeve.

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

I.1 Informimi dhe respektimi i Kodit Etik të industrisë së sigurimeve

Dispozitat e Kodit, janë të aplikueshme për të gjithë siguruesit dhe personat juridik qe mirren me sigurime, te cilët janë të licencuar për të vepruar në territorin e Republikës së Kosovës. Siguruesit, janë të obliguar, që në mënyrë të përshtatshme, ti paraqesin në media apo publikojnë në internet, web faqe, apo postë elektronike, ti informoj të gjithë partnerët afarist, si personat juridik dhe fizik, të cilët në llogari të siguruesit, në bazë të kontratës për përfaqësim apo në bazë të ndonjë kontrate tjetër mbi ofrimin e shërbimeve tjera në lidhje me sigurimet, kryejnë punë tjera të sigurimeve, me qëllim të informimit, e njëkohësisht të siguroj respektimin e mirëfilltë të dispozitave të parashtruara në këtë Kod.

Siguruesit nuk i arsyeton fakti, se nuk kanë pasur njohuri, me rastin e shkeljes së dispozitave të Kodit, duke u arsyetuar, se ka munguar informimi i të punësuarit, apo personave që me kontratë janë të autorizuar si persona fizik dhe juridik për kryerjen e biznesit lidhur me sigurimet.

1.2. Përgjegjësia e personave juridik të perfshirë në industrinë e sigurimeve

Siguruesit, janë të obliguar, që të përcjellin dhe mbikëqyrin të gjithë personat fizik dhe juridik, të cilët në llogari të tyre kryejnë veprimtari lidhur me sigurimet. Nëse ata persona, gjatë veprimtarisë së afarizmit të sigurimeve, cënojnë dispozitat e Kodit, konsiderohet se vet subjekti juridik, për të cilën në emër dhe llogari të tij ka vepruar si personi fizik dhe juridik, e cila ka toleruar një sjellje të tillë.

1.3. Mbrojtja e autoritetit të siguruesve

Siguruesit, janë të obliguar të kërkojnë nga të gjithë të punësuarit e rregullt, si dhe personat e tjerë, fizik dhe apo juridik, të cilët janë të angazhuar në afarizmin e sigurimeve, të kenë marrëdhënie profesionale ndaj, punës dhe të sigurojnë njohuri të lartë profesionale, me rastin e pranimit të rrezikut, vlerësimit të dëmit dhe trajtimit të punëve që rrjedhin nga lëmia e sigurimeve.

Të gjithë të punësuarit e rregullt si dhe ata të angazhuar me kontratë, qofshin persona juridik apo fizik, që me rastin e kryerjes së detyrate për të cilat janë caktuar, duhet të respektojnë dispozitat e përgjithshme të Kodit, e sidomos me rregullat e ndershmërisë dhe sinqeritetit, me çka janë të obliguar që të kujdesen që me sjelljen e tyre të mos dëmtohet autoriteti i personave juridik të sigurimeve, si dhe tregut të sigurimeve në Kosovë dhe jashtë saj.

1.4. Parimi i besimit reciprok dhe e drejta për mbrojten e palës

Siguruesit, në relacion me palët, duhet të themelojnë një bazë të principit të besimit reciprok dhe principit të së drejtës për mbrojtjen e palës, duke respektuar dispozitat juridike nga lëmia e sigurimeve.

1.5. Marrëdhëniet e siguruesve dhe personave tjerë

Marrëdhëniet e siguruesve dhe personave fizike juridik, të angazhuar në lëmin e sigurimeve, duhet të janë kolegiale dhe të bazuara në principin e profesionalizmit.

Të gjitha mosmarrëveshjet, dhe konfliktet e mendimeve të ndryshme, duhet të zgjidhen me bisedime, me marrëveshje të përbashkëta në bazë të parimit të respektimit reciprok dhe në bazë të rregullave të sjelljeve afariste në lëmin e sigurimeve.

1.6. Angazhimi mbi zhvillimin mëtejmë të veprimtarisë së sigurimeve

Siguruesit, të cilët operojnë në Kosovë në industrinë e sigurimeve janë të obliguar, që të angazhohen për zhvillimin e mëtejmë të tregut të sigurimeve dhe të bëjnë plotësimin e njojurive të reja profesionale në sigurime permes trajnimeve si dhe edukimit të publikut për rëndësin e sigurimeve.

II. MARRËDHËNIET NDAJ PALËVE

2.1. Informimi i drejt i palëve para lidhjes së kontratës të sigurimit

Siguruesit, para lidhjes së kontratës të sigurimit, duhet të ofroj të dhëna të sakta, me kërkesë të vet palës, plotësisht dhe në detale të informoj mbi statusin e vet, finaciar, organizativ, kadrovik dhe të dhënave tjera përmundësinë e ofrimit të shërbimeve dhe mbulesës së rrezikut që rrjedh nga sigurimi, me paraqitjen e rastit përkompensi.

Siguruesit janë të obliguar që para lidhjes së kontratës së sigurimit, palën plotësisht dhe drejtë ta informojë mbi kushtet e sigurimit, çmimet e premisë, mundësive të mbrojtjes së sigurimit dhe mënyra e realizimit të të drejtës dhe obligimeve nga kontrata mbi sigurimin, respektivisht ti përshtatet të siguruarit mbrojtja e kushteve të siguruara.

Siguruesit janë të obliguar, që të përpilojnë kushtet e sigurimit dhe çmimet e primit, me një gjuhë të kuptueshme dhe të qartë, pa terme të cilat mund të aplikohen në mënyra të ndryshme, apo me ato që palën mund ta bien në lajthim. Kushtet e sigurimit dhe çmimet e primit, në asnjë rast nuk guxojnë të përmbajnë kushte jo të favorshme apo elemente, të cilat do të jenë në kundërshtim me dispozitat juridike të aplikueshme në Kosovë, e të cilat do të jenë në kundërshtim me parimin e besueshmerisë, duke krijuar një situate të favorshme në të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese në dëm të palës, për shkak të keqpërdorimit të pozitës në kompani si palë më e fuqishme.

2.2. Trajtimi i pa anshëm i palëve dhe trajtimi i kompenzimit të dëmit sipas kushteve te kontratës së sigurimit

Siguruesit, duhet ti trajtojnë palët në mënyrë të pa anshme me rastin e lidhjes së kontratës së sigurimit dhe marrëdhënie të njejtë me të gjitha palët. Siguruesit do të ndërmarrin masa me të cilat palët sa më thjesht dhe shpejt do ti realizojne të drejtat e veta dhe të gjitha mosmarrëveshjet, kur është ajo e mundur, do ti zgjidhin me anë të rruges së drejtë, me proces jashtëgjyqësor, duke i ikur krijimit të shpenzimeve të panevojshme administrative dhe gjyqësore. Palët sipas mundësisë, do të shkojnë për të zgjidhur rastet me ujdi jashtëgjyqësore.

Në procedurën e trajtimit të dëmit dhe kompenzimit të shumës së siguruar, kompanitë janë të detyruara, që të veprojnë profesionalisht, drejt dhe ti ikin çdo zvarritjeje të pagesës së shumës, e cila është përcaktuar në kushtet e kontratës së sigurimit.

Drejtorët, nëpunësit dhe punëtorët e siguruesit, duhet të veprojnë në mënyrë të paanëshme dhe të drejtë, për t'i ruajtur interesat e poseduvesve të policave të tyre.

2.3. Zgjidhja e ankesave të palëve

Me qëllim të ruajtjes së autoritetit dhe besimit në punën e saj, siguruesit janë të obliguar, që sipas ankesave të palëve të veprojnë me kujdes dhe shpejtë, duke respektuar të drejtat e palëve.

Siguruesit janë të obliguar që të veprojnë konform me dispozitat të procedurës së ankesave, të cilat duhet ti përbajnë këto elemente:

- a. Pala duhet që në çdo ankesë me shkrim të pranoj përgjigje me shkrim,
- b. Pala në ankesë me anë të postës elektronike, njashtu të pranoj përgjigje të njejtë.
- c. Përgjigja përfundimtare në ankesë, në formën me shkrim dhe të derguar në rrugën elektronike, duhet të përbajë udhëzimet juridike, me çka do të mund të vazhdoj procedurën e mëtejme, lidhur me kompenzimin e dëmit, me anë të rrugës jashtëgjyqësore.
- d. Përgjigja përfundimtare në formë me shkrim dhe në mënyre elektronike në ankesë, duhet të jetë në afatin e paraparë me dispozita juridike si dhe ato të përgjithshme.
- e. Nëse kalon afati i parashtrimit të përgjigjes në ankesë, kompania duhet ta informoj palën për shkaqet e kësaj vonese.

2.4. Aplikimi i dispozitave juridike dhe rregullave të sigurimeve

11. Siguruesit, obligohen që me rastin e kryerjes së veprimtarisë së tyre të aplikojnë të gjitha dispozitat juridike lidhur me sigurimet dhe Ligjin mbi Marrëdhëniet Detyrimore si dhe ligjet e tjera të cilat e rregullojnë fushën e sigurimeve.

III. MARRËDHËNIET NË MES TË OPERUESVE TË SIGURIMEVE

3.1. Parimet kryesore

Marrëdhëniet në mes të operuesve të sigurimeve, janë të themeluara sipas parimit të mirëbesimit të ndërsjellë, respektin reciprok, duke iu përmbajtë lëmisë së sigurimeve, praktikave të mira afariste dhe moralin e lartë të veprimit, me qëllim të zhvillimit dhe ngritjes së autoritetit të këtij biznesi, në vend dhe ndërkombetarisht.

3.2. Solidariteti reciprok

Siguruesve, të cilëve në afarizmin e tyre u lajmërohen vështiresi, siguruesit tjerë do të ofrojnë ndihmë profesionale, nëse ajo e kërkon. Sigurusit e tjerë, në çdo rast nuk do të shfrytëzojnë rastin dhe të krijojnë një situatë me çka do ta vështirësojnë edhe më tepër pozitën dhe do të cënojnë autoritetin e lëmise së sigurimeve me çka do ta humbin besimin e palëve në përgjithësi.

IV. MBLEDHJA, TRAJTIMI, SHFRYTËZIMI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

4.1. Mbledhja, trajtimi, shfrytëzimi dhe mbajtja në diskpcion i të dhenave dhe mbrojtja e të dhënave personale

Siguruesit, në afarizmin e vet, i mbledhin, trajtojnë dhe shfrytëzojnë në diskpcion të plotë të dhënat dhe ato personale, të nevojshme për lidhjen e kontratave mbi sigurimin dhe trajtimin e kërkesave për dëme, respektivisht kërkesave per kompenzimin e shumës së kontraktuar në harmoni me dispozitat juridike dhe akteve ligjore të aplikueshme në Kosovë.

4.2. Mbedhja, trajtimi dhe publikimi i të dhënave që kanë te bëjnë me afarizmin e kompanisë

Siguruesit, janë të obliguar, në respekt dispozitave ligjore të bëjnë publike në webfaqet e tyre zyrtare të dhënat financiare dhe raportin e Auditorit të jashtëm.

4.3. Shkëmbimi i të dhënave në mes të Siguruesve

Siguruesit obligohen në shkëmbimin reciprok të të dhënave, kryesisht në lëmin e ndalimit të mashtrimeve në sigurime dhe kompenzimet e pa baza të dëmeve. Poashtu, siguruesit, janë të obliguar të veprojnë në harmoni me dispozitat juridike, të cilat rregullojnë diskpcionin e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

V. PREZENTIMI I SIGURUESVE NË TREG

5.1. Respektimi i konkurrencës së tregut të lirë

Siguruesit janë të obliguar që të veprojnë konform me dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë veprimtarinë e sigurimeve dhe të respektojnë kryesisht konkurrencën në tregun e lirë dhe lojal, rregullit të lemisë së sigurimeve, përvojave të mira afariste. Përparësit në treg të ndonjë siguruesi, e cila është rezultat i aftësisë më të madhe, zgjërimi të aftësisë profesionale, dhe të cilat janë të ndikuara me rezultat më pozitiv financiar, me përbushjen më të sukseshme të kërkesave të palëve, me shpenzime më të ulta dhe pjesmarrjen më të madhe në treg, nuk duhet me asgjë të kufizohen.

5.2. Promociioni Ekonomik

Siguruesit munden të shfrytëzojnë të gjitha mjetet e reklamimit dhe format e ofertave, të cilat nuk paraqesin konkurrence jo lojale në treg në mes të kompanive, ato të cilat bazohen në parim me realitetin e të dhënave.

5.3. Sjellje e pa tolerueshme

Çdo sjellje, e siguruesit, me rastin e funksionimit të veprimtarisë në treg, lidhur me sigurime, në kundërshtim me dispozitat e Kodit, do të konsiderohen si cenim i Kodit, respektivisht të pa tolerueshme, e sidomos:

- a. Ofrimi i lidhjes së kontratës në kundërshtim me aktet ligjore të aprovuara nga organi mbikëqyres dhe lirimi i pa bazë të premisë.
- b. Zvarritja e procedurës së trajtimit të kërkesave të dëmeve dhe kompenzimi i tyre, refuzimi i kompenzimit për parametrat të pa kontestuara dhe kompenzimi jo real i dëmit, respektivisht refuzimit të dëmit, i cili është i definuar dhe i kontraktuar ne kontratën e sigurimit.
- c. Kushtëzimi i kompenzimit të një forme të dëmit me tërheqjen nga kërkesa për një formë tjeter të dëmit, respektivisht ofertë e pa favorshme.
- d. Oferta e kompenzimit të dëmit në mënyrë që është në kundërshtim me praktikën e zhdëmtimit dhe të dispozitave ligjore.
- e. Dhënya e të dhënave të pa kompletuara, jo të sakta, palëve mbi përbajtjen e kontratës, apo fshehja e elementeve esenciale të kushteve të sigurimit, me çka palën e vëjnë në lajthim, dhe mund të dëmtohet
- f. Dhënya e të dhënave mbi palët, në kundërshtim me ligjet dhe dispozitat juridike përkatëse, pësonit të pa autorizuar.
- g. Dhënya dhe përhapja e të dhënave jo të sakta, për ndonjë sigurues, lidhur me aftësin financiare, teknike dhe profesionale.
- h. Publikimi i të dhënave jo të sakta apo termeve, me të cilat mund të jete në favor të një siguruesi, me çka do të vihen në pozitë të pa volitshme kompanitë tjera.

- i. Lidhja e marrëveshjes së dy apo më tepër siguruesve, të cilët kanë për qëllim të kufizimit të lirisë së tregut, në krahasim me siguruesit tjera në territoret e caktuara.
- j. Kompenzimi i primit të sigurimit në kundërshtim me kushtet dhe dispozitat e parapara në aktet ligjore.
- k. Ofrimi apo mundësimi i pasurimit material, kontraktuesit të sigurimit apo personit të autorizuar si shpërblim për lidhjen e kontratës së sigurimit, nga personi, i cili në bazë të autorizimit është kompetent për lidhjen e kontratës së sigurimit.
- l. Zbatimi i kushteve të pabarabarta të afarizmit ndaj punëve të ngjashme me sigurues të ndryshëm, me çka disa nga siguruesit vihen në pozitë të papërshtatshme në raport me konkurrentët.
- m. Sigurohet lidhja e kontratave të sigurimeve, duke pranuar të drejta dhe detyrime suplementare, të cilat, duke marrë parasysh natyrën, traditën dhe praktikën komerciale, nuk kanë lidhje me lëndën e kontratës së tillë të sigurimit;
- n. E mbyll tregun e sigurimeve për t'i përjashtuar siguruesit e tjera;

VI. KONKURENCIA JO LOJALE NË VEPRIMTARINË E SIGURIMEVE

Konkurenca jo lojale është veprim që është në kundërshtim me traditën e mirë e me moralin afarist me të cilin i shkaktohet ose mund t'i shkaktohet dëmi pjesëmarrësve të tjerë në tregun e sigurimeve, sidomos:

1. Kur pjesëmarrësi në tregun e sigurimeve shpall, propagandon ose reklamon (me propagandë ekonomike) afarizmin e vet, duke përdorur të dhëna të pasakta ose me shprehje të atilla, të cilat krijojnë paraftyrim të gabueshëm në dobi të tij në raport me pjesëmarrësit e tjerë në treg, ose përjesëmarësit e tjerë me ato të dhëna vihen në pozitë të papërshtatshme;
2. Paraqitja e të dhënave të pasakta ose e të pavërtetave për pjesëmarrësin tjetër në tregun e sigurimeve, që e dëmtojnë besueshmërin në treg;
3. Ndërmarrja e veprimeve të drejtuara kah shkëputja e marrëdhënieve afariste ndërmjet pjesëmarrësve të tjerë në tregun e sigurimeve ose pengimi, përkatësisht vështirësimi i krijimit të marrëdhënieve të atilla;
4. Përfitimi i të siguruarve dhe i shfrytëzuesve të tjerë të sigurimeve, duke dhënë ose duke premtuar dhënie të shpërblimeve ose të ndonjë përfitimi tjetër pasuror ose ndonjë lehtësimi, vlera e të cilit e tejkalon vlerën e shpërbllimit të rëndomtë reklamues;
5. Lidhja e kontratave të sigurimeve sipas çmimeve që janë nën nivelin e tarifave të aprovuara nga BQK
6. Ofrimi dhe lidhja e kontratave të sigurimeve sipas tarifës së primit për të cilën nuk është marrë mendimi pozitiv i aktuarit të autorizuar;
7. Ofrimi dhe lidhja e kontratave të sigurimeve duke pranuar të drejta dhe detyrime suplementare në kundërshtim me lëndën e sigurimit të këtillë;
8. Pagesa e kërkesave për dëmshpërblime, përkatësisht e shumave siguruese, që nuk janë mbuluar me sigurim;
9. Dhënia e të dhënave të pasakta për veten ose sa i përket kushteve të sigurimit, të primit të sigurimit, aftësisë profesionale dhe teknike lidhur me ofrimin efikas dhe profesional të shërbimeve, siç janë shërbimet e vlerësimit, të likuidimit dhe të pagesës së dëmshpërblimeve dhe të dhëna të tjera;
10. Kur siguruesi ia premton ose ia bën të mundshëm përfitimin pasuror kontraktuesit ose personit të autorizuar të kontraktuesit të sigurimit si shpërblim me qëllim që ta përvetësojë të siguruarin;
11. Lejimi i pabazuar i bonusit ose mosllogaritja e qëllimshme e shumave ndëshkuese (malusit) të parapara me tarifë, për kontraktuesin e sigurimit për shkak të mangësive që të merret informata e besueshme (e saktë burimore), e cila tregon se bonusi nuk ka mundur të lejohet, përkatësisht se malusi ka qenë detyrim që të përllogaritet.

VII. SPEKULIMI NË PUNËT E SIGURIMEVE

Spekulimi është realizim i përfitimit të pabazuar pasuror i siguruesve ose të pjesëmarrësve të tjerë me shkaktimin e çregullimeve në tregun e sigurimeve ose me anë të shtimit apo zvogëlimit të paarsyeshëm të primit të sigurimit.

Spekulim konsiderohet veçanërisht:

1. Vështirësimi ose pamundësia e lidhjes së kontratës së sigurimit;
2. Lidhja e kontratave fiktive të sigurimit;
3. Kushtëzimet në mënyra të tjera për lidhje të kontratave të sigurimit.

VIII. PARANDALIMI DHE SANKSIONET PËR SHKELJE TË KODIT

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, do të organizojë aktivitetin sistematik për ngritje të moralit afarist, duke vepruar, para së gjithash me pjesëmarrësit në punët e sigurimeve, si edhe në krijimin e opinionit publik për gjykimin më energjik të rasteve të shkeljes së moralit afarist.

8.1 Masat për shkelje të Kodit janë:

1. Vërejtja që shpallet në Bordin e Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës
2. Kërkesë drejtuar BQK-së, për marrjen e masave ndaj Kompanisë e cila e ka shkelur Kodin
3. Vërejtja publike, që publikohet në më shumë gazeta të shtypit ditor dhe mediume tjera.

IX. KOMISIONI PËR SHKELJEN E KODIT ETIK

Për shqiptimin e masave për shkelje të rregullave të këtij Kodi, kompetentë është Komisioni për Shkeljen e Kodit Etik i cili formohet nga Bordi i Shoqatës së Sigurimeve. Ky komision përbëhet nga tre anëtar dhe është i përhershëm

9.1. Për nisje të procedurës për shkelje të Kodit është kompetente, pos personave që e kanë atë autorizim edhe Bordi i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës.

9.2 Punët administrative, teknike dhe punët e tjera për punën e Komisionit i siguron dhe i kryen shërbimi profesional i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës.

X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

10.1. Informimi me Kodin

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, do ta publikojë këtë Kod në formë të shkruar si dhe në mënyrë elektronike për të gjithë anetarët e Shoqatës, si dhe palëve tjera të interesit dhe më gjérë.

10.2. Hyrja e Kodit ne fuqi

Kodi konsiderohet se ka hyrë në fuqi, me aprovizimin nga Bordi i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës.

Të gjitha ndryshimet dhe plotësimet do të bëhen në të njejtën mënyrë.



KODI ETIK I INDUSTRISË
SË SIGURIMEVE